

Qani Nesimi, PhD<sup>1</sup>  
Refije Rexhepi, MA<sup>2</sup>

UDC: 17:502/504

**NDOTJA E AMBIENTIT DHE PRISHJA E RAPORTEVE NDËRNJERËZORE  
SI PASEFEKT I PËRLYERJES SË BRENDEËSISË SË NJERIUT**

**ЗАГАДУВАЊЕТО НА ЖИВОТНАТА СРЕДИНА И НАРУШУВАЊЕТО  
НА МЕЃУЧОВЕЧКИТЕ ОДНОСИ КАКО ПОСЛЕДИЦА НА  
ОСКВЕРНАВАЊЕТО НА ЧОВЕЧКАТА ВНАТРЕШНОСТ**

**ENVIRONMENTAL POLLUTION AND THE BREAKDOWN OF  
INTERPERSONAL RELATIONSHIPS AS AN AFTEREFFECT OF  
DEFILEMENT OF THE HUMAN INTERIOR**

**Abstract**

In this article, will be analyzed the defect of the crisis in general and the spiritual crisis in particular. Today, the world needs more than ever, for an elevation and advancement of spirituality, for a non-abuse of the sacred, so that we do not have pollution of the environment and pollution of interpersonal relationships. Man, as always, is between two decisions, to decide to sacrifice himself for the good, or to think only about the realization of his own desires, that is, to sacrifice the other to realize his desires. Therefore, the reflection of man towards the environment is an unfolding of what he has inside him.

When the Qur'an defines man, it shows that he is essentially the main cause of problems, disorders, perversions, crises, etc.. This is understood from the terms with which man is defined in the Qur'an: *haluan* (Man was created not calm, unbearable), *dhaluman jahula'* (... he is unjust, barbaric) etc.. The ecological crisis and the lack of interpersonal relationships, which above all, is an after-effect of the defilement of the soul, also shows the general condition of humanity and the

---

<sup>1</sup> Prof. Dr., Fakultetit Filozofik, Universiteti i Tetovës, Republika e Maqedonisë së Veriut. Email: qani.nesimi@unite.edu.mk

<sup>2</sup> MA., Fakultetit Filozofik, Universiteti i Tetovës, Republika e Maqedonisë së Veriut. Email: refije.rexhepi@unite.edu.mk

planet, for regarding the extreme threat to the natural human environment, including air, land, water and plant and animal species.

**Keywords:** *Environmental pollution, crisis of faith, ecological crisis.*

## Hyrje

Shikuar nga aspekti primordial, antropologjik apo kulturologjik, njeriu, gjegjësisht, njeriu besimtar, në vazhdimësi, ashtu siç ka qenë i sfiduar nga kërcënimi i të keqes në relacion me veten, ambientin, tjetrin dhe Zotin, ai gjithashtu ka qenë dhe është një sfidë shumë serioze për të keqen. Besimi ka prezantuar dhe prezanton segmentin e flijimit për të mirën, vlerën, të bukurën, estetikën dhe etiken.

Sot jemi duke jetuar në një ambient ku mungon e mira, vlера, e bukura, estetikja, etikja, gjegjësisht, jetojmë në një ambient të ndotur, edhe lokal edhe global. Të gjithë jetojmë në këtë ambient të ndotur dhe të gjithë jemi duke kërkuar fajtorin për këtë. Mendoj se, të gjithë jemi fajtor për këtë. Dikush është fajtor direkt/aktiv, dikush është fajtor indirekt/pasiv, e dikush tjetër, nga ajo që nuk ka mundësi të veprojë ndryshe, por derisa është duke jetuar dhe nuk e ngre zërin, është gjithashtu fajtor. Ajo që nuk ka faj në këtë rast është vetë natyra/ambienti, por që vazhdon të sulmohet me ndotje dhe shkatërrim nga vetë njeriu. Me plotë të drejtë, profesor Gulzar Haider në një intervistë dhënë profesor Ziauddin Sardarit, do të shprehej me sa vijon: “Natyra, për shembull, do të kishte dashur të kishte të drejtën për të mos u dhunuar dhe abuzuar në mënyrë të panevojshme. Natyra nuk do të donte t’i kishte ciklet e saj ekologjike të çrregulluara. Jam i sigurt se pyllit nuk i pëlqen shiu acidik”.<sup>3</sup>

Njeriu është ai që vendos për pastërtinë apo ndotjen e natyrës/ambientit. Natyra në esencë është e pastër, është e papërlyer dhe e pandotur. Ajo në vete është kompatibël me të bukurën dhe të mirën. Ashtu sikur njeriu, si krijesë më e përsosur dhe me përgjegjësi, kur lind është i pastër dhe pa ndjenja urrejtjeje dhe bindje shkatërruese, por më vonë duke i ngatërruar përparësitë/prioritetet, pra në vend që t’i jep përparësi arsyes, bindjes dhe besimit, ai fillon t’i jep përparësi lakmisë, epshit, aspiratave të pangopura të tij, edhe më keq është kur ato i bën duke i përdorur edhe mundësitë dhe aftësitë e pushtetit, të parasë apo të autoritetit, ai bëhet shkatërrues dhe ndotës i ambientit dhe i raporteve

<sup>3</sup> Ziauddin Sardar, *Fryma e Islamit*, LogosA, Shkup, 2017, f. 142.

ndërnjerëzore. Prandaj, gjithmonë, është shumë me rëndësi, që njeriu, rregullisht, t'i kthehet vetes, ta njoh veten, ta di përgjegjësinë që ka ndaj Zotit, ndaj ambientit dhe ndaj tjetrit.

Njohja e vetes për njeriun, ka kuptimin e njohjes së pozicionit, mëkëmbësisë dhe përgjegjësisë që ka ndaj Krijuesit, tjetrit në shoqëri dhe ndaj ambientit që e rrethon. Ai duke e njohur veten edhe më tepër e njeh tjetrin dhe atë që e rrethon. Prandaj, fjala e urtë thotë: "Ai që e njeh veten e tij, e njeh Zotin e tij". Nëse njeriu e ka të qartë vendin e tij në natyrë, shoqëri, e cila nga ana e Krijuesit quhet mëkëmbësi (hilafetesi)<sup>4</sup>, ai kontribuon dhe është aktiv në rregullimin e marrëdhënieve ndërnjerëzore dhe në mbrojtjen e ambientit nga ndotja. Prandaj ndjenja dhe vetëdija e mëkëmbësisë individuale është esenciale ndaj mëkëmbësisë politike, mëkëmbësia shoqërore politike është esenciale për një mëkëmbësi ambientale apo ekologjike.

### **Formësimi i brendshëm thelbësor në ruajtjen e raporteve me njerëzit dhe në ruajtjen e ambientit**

Etika, në esencë, në urtësinë origjinale të ligjit, është operative. Por, mënyra se si manifestohet ajo në ditët e sotme, definitivisht nuk është operative. Ne duhet të synojmë etikën që i jep jetë sensibilitetit ambiental, si dhe elokuencën simbolike të arkitekturës, indin e butë të një qyteti (të një personaliteti), proces i cili duhet të studiohet dhe të kuptohet. Ne duhet të rifillojmë rithemelimin e dimensioneve etike të menaxhimit ambiental, të dizajnit ambiental.<sup>5</sup>

Në dimensionin që po i referohem kësaj çështje, njohja është baza e personalitetit tonë. Njohja është fizike, logjike, shpirtërore dhe besimtare. Në fakt njohja është një tërësi. Ajo nuk e ndanë veten në pjesë. Atë e ndajmë ne. Por, kur ne veprojmë ajo prezantohet si tërësi, si tek tjetri, gjegjësisht te të kuptuarit e tjetrit, te të pamurit e tjetrit, te të nuhaturit e tjetrit, pra, atje ajo merr 'formë' duke buruar nga tërësia. Prandaj shpesh ndodh te definimet e tjetrit të dëgjojmë përgjigjen: "Ky qenka njeri i keq!". Edhe pse ai mund të jetë një njeri shumë i 'ngritur' në profesionin, në karrierën apo në kapitalin e tij. Por, fatkeqësisht, pritja nga tjetri, përshtypja që është e krijuar për të te tjetri, me një veprim jo të pritsëm, reflekton me përgjigjen: "Ky qenka njeri i keq!" Këtu flet ajo që nuk ka zë, pra, pazëshmëria. Këtu flet ajo që dëgjohej vetëm nga

<sup>4</sup> Kur'an, el-Bakare, 30.

<sup>5</sup> Sardar, *Fryma e Islamit*, f. 145-149.

veshi i njerëzisë. Këtu flet ajo që, vepruesi, shumë herë nuk e dëgjon, nuk dëshiron ta dëgjojë fjalën e tij, apo nuk dëshiron ta kuptojë veprimin e tij. Ndërkaq, kur njeriu vepron mirë, sillet mirë, dhe pret nga tjetri që të sillet ashtu, apo kur tjetri surprizohet për të mirë, duke mos e pritur një gjë të tillë, nga goja e tij, edhe spontanisht, del në pah shprehja: “Ky qenka njeri i mirë!”.

“Ndodh që organet tona të njohjes ta humbasin kujtesën për Fytyrën e Zotit”, thotë profesor Reshidi, “atëherë kur në aktin tonë të njohjes/besimit zhduket serioziteti, përkora, përkushtimi dhe, sidomos, sjellja e bukur me ‘objektin’ e njohjes, çfarëdo qoftë ai dhe në cilindo nivel të Manifestimit qoftë.”<sup>6</sup>

Sjellja e mirë, e bukur, e etikshme e njeriut tregon për tërësinë e tij, gjegjësisht, kuptohet se prapa saj fshihet fjala, qëllimi dhe një personalitet i mirë e i formuar. Edhe e kundërta tregon tërësinë e njeriut. Profesor Reshidi thotë: “Mungesa e ‘sjelljes së bukur’, respektivisht etikës dhe moralit, vlerës së përshpirtshme dhe virtytshmërisë morale është shenjë e qartë e shkujdesjes sonë, që e errëson kujtesën tonë për Zotin, ashtu që sapo ne të pushojmë së kujtuari Atë, edhe Ai pushon së na kujtuari...”<sup>7</sup>

Nëse ne nuk e kemi të qartë elementin sovran të besimit tonë, të njohjes sonë, atëherë ne jemi të cekët, apo jemi joorigjinal, gjegjësisht paraqitemi rrejtshëm, por, për një kohë shumë të shkurtër dhe pa rezultat. Neve na duket se jemi në dritë, realisht ne jemi në errësirë. Kur neve na mungon Sovrani, gjegjësisht bërthama, apo kur na mungon ajo që profesor Reshidi e quan ‘Kujtesa për Fytyrën e Zotit’, në formimin e bindjeve tona, në sjelljet tona, gjegjësisht kur në formimin tonë na mungon vetëdija për sovranin, i Cili i jep kuptim besimit, njohjes, sjelljes dhe qenies-ekzistencës tonë, atëherë ne jemi në errësirë. “Me zbehjen e kujtesës për Fytyrën e Zotit, zbehet edhe drita e njohjes në kapacitetet tona njohëse, ndaj ato nuk janë më në gjendje të shikojnë ngultas në bërthamat dhe natyrat zanafillore të objekteve të tyre të njohjes. Kur drita e njohjes të fillojë të zhduket, bashkë me Fytyrën e Zotit, që është i vetmi burim i dritës së qiejve dhe Tokës, organet tona të njohjes dhe i tërë personaliteti ynë kalojnë nga gjendja e dritës në gjendjen e errësirës, nga mbizotërimi i bërthamave, ose thelbeve të gjërave që janë të stërholluara, transparente dhe të shkëlqyeshme, nën

<sup>6</sup> Reshid Hafizoviq, *Njohja-vlera e parë e Islamit*, Alsar, Tiranë, 2022, f. 278-279.

<sup>7</sup> Hafizoviq, *Njohja-vlera e parë e Islamit*, f. 278.

mbizotërimin e formave, “maskave” të gjërave që janë të errëta, jotransparente dhe të errësuar.”<sup>8</sup>

Fuqia e brendësisë së njeriut është esencialja, realja e tij. Nga aty merr forcë, manifestohet gjithçka që duket në sjelljen dhe mendimet e njeriut. Prandaj profesor Reshidi thekson: “... ‘Lutja e mendjes’ (fikir) tashmë ta forcojë ‘Lutjen e zemrës’ (dhikr), ndërsa kjo e fundit ia kthen ashtu që tashmë e thellon dhe e bën aq më perceptuese ‘lutjen e mendjes’,...”<sup>9</sup>

Gjithashtu, ne po përfetojmë një kohë kur keqpërdoret liria, pasojë e së cilës është ndotja e raporteve ndërnjerëzore dhe e ambientit. Flasim, gjithnjë, për lirinë si një vlerë elementare të njeriut, por realisht, faktikisht, ballafaqohemi me një liri të plotë të dikush, dhe të cunguar te dikush tjetër. Ai që është më i ‘fortë’ me autoritet, me karrierë gjithmonë ka të drejtë të plotë. Kurse ai që nuk i posedon këto mundësi, nuk e gëzon këtë liri. Dhe, edhe më e keqja është se, ky lloj veprimi quhet e drejta e lirisë, qoftë të jetuarit, qoftë të të shprehurit, të besuarit, të fituarit etj. Ndërkaq liria nuk mund të jetë e privuar nga e mira, e bukura, estetikja. Nëse liria do të ishte autonome nga këto, ajo nuk do të quhej liri. Prandaj me plotë të drejtë, profesori dhe politikani i Lindjes së Largët, M. Mahatir thotë: “... unë besoj në lirinë e shtypit, por çka nëse ‘liria’ e një gazetari shkakton humbjen e lirisë për të jetuar një jetë të ndershme për shumë njerëz të tjerë?”... ‘Unë pajtohem me lirinë e shtypit, por, vetëm për derisa ajo nuk përdoret për t’ua vjedhur lirinë, dinjitetin dhe mirëqenien të tjerëve. Modernizimi i mendjes ishte parakusht për modernizimin e ekonomisë.”<sup>10</sup>

Kështu që, ruajtja apo pastërtia edhe e ambientit, edhe e raporteve ndërnjerëzore nuk mund të mendohet ndryshe, përveç se nga këto dimensione të lartpërmendura, nga të cilat nuk mund të jetë e privuar asnjëherë. Reflektimi i njeriut edhe ndaj ambientit, është një shpalosje e asaj që ai e ka në brendësi, gjegjësisht në ambient reflekton besimi/bindja i tij.

Libri i Shenjtë kur e definon njeriun tregon se ai në esencë është shkaktari kryesor i problemeve, çrregullimeve, çoroditjeve, krizave etj. Kjo kuptohet nga termat me të cilat definohet njeriu në Kur'an: haluan<sup>11</sup> (Njeriu u krijua jo i qetë - i padurueshëm), dhaluman xhahula’ (... ai

<sup>8</sup> Hafizović, *Njohja-vlera e parë e Islamit*, f. 279.

<sup>9</sup> Hafizović, *Njohja-vlera e parë e Islamit*, f. 279.

<sup>10</sup> Mahatir Muhamed, *Një marrëveshje e re për Azinë*, BFI-FSHI, 2004, f. 46 dhe 88.

<sup>11</sup> *el-Me'arixh*: 19.

është i padrejtë, barbar)<sup>12</sup> etj. Por në anën tjetër Kur'ani atë, njeriun, e quan edhe si 'ahseni takvim' (Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur). Kjo është kështu atëherë kur njeriu ka qartësi dhe bindje të plotë, si dhe është i vetëdijshëm për mëkëmbësinë dhe për prioritetet e përgjegjësisë së tij.<sup>13</sup>

E para tregon karakterin e tij, sipas së cilit ai mund të vendos, të veprojë etj., kurse sipas së dytës, kuptohet se ai është krijuar si krijesa më e mirë dhe më e përsosur, e cila ka fuqi ta kontrollojë, ta gdhendë dhe ta edukojë të parën, gjegjësisht karakterin e tij. Njeriu, pra, është krijesa më e mirë e krijuar nga Ai, por, në karakter është vetjak, egoist, i vrazhdë, i pagdhendur, i padurueshëm. Atë e gdhendë besimi, bindja dhe e shenjtja. Vetëm fuqia hyjnore/e besimit, e të shenjtës ka mundësi që atë ta avancojë në dimensionin e një njeriu të 'përkryer'; njeri që do jetë i kujdesshëm ndaj vetes, shoqërisë dhe ambientit ku jeton. Pasi njeriu me bindje të sinqertë, gjegjësisht, me brendësi të paqtë, dominohet nga bindja se për çdo fjalë, mendim e veprim ai vëzhgohet, regjistrohet dhe vlerësohet nga tjetri dhe Krijuesi i tij.

Njeriu për të kuptuar përgjegjësinë e tij, atij i duhet 'dritë'. Drita simbolizon besimin në Zot. Njeriu që ka besim, ai e ka dritën, dhe e sheh rrugën që e ecë. Drita e besimit njeriun nuk e lejon që të jetë i dëmshëm as edhe për ambientin. Simbolizmi i dritës-errësirës me burim hyjnor, që mendimtarët muslimanë do ta përdornin shpesh në shekujt e mëvonshëm, nënkupton se të vërtetën mund ta rrokim vetëm kur arrijmë dritën. Po ashtu, falë kësaj drite mund ta kuptojmë se një gjë është hije apo e vërtetë. Edhe sikur t'i kemi të hapura të gjitha shqisat e perceptimit, nuk mund të shohim asgjë në errësirë. Për t'i dalluar qeniet përreth nesh, kemi nevojë për dritë. Në këtë kuptim, vështrimi shpreh jo një akt pasiv, por një proces aktiv perceptimi. Fushat e dijes që i quajmë shkenca teorike, gjithashtu nuk janë thjesht perceptime mendore, por i referohen shikimit me sy të fenomeneve të së vërtetës. Edhe fjala greke "theoria", do të thotë "të vështrosh"; ajo çka vështrojmë, na prezantohet dhe na jep mesazh për ekzistencën dhe realitetin e saj. Të vështrosh do të thotë të përpiqesh të kuptosh. Qëllimi i qasjes teorike nuk është të krijojë projekte të gjërave në mendje, por të zhvillojë një vetëdije rreth kuptimit të tyre. Prandaj mendimi teorik nuk është vetëm një proces pasiv, abstrakt dhe mendor, por, siç thotë profesor Ibrahim Kallën, është një përpjekje për të rrokur realitetin e gjërave. Të mendosh do të

<sup>12</sup> *el-Ahzab*: 72.

<sup>13</sup> *et-Tin*: 4.

thotë të dalësh nga errësira në dritë për të depërtuar në të vërtetën e gjërave.<sup>14</sup> Dhe kështu mund të vepohet suksesshëm edhe në rrethin ku jetojmë. Në rast mungese të këtij dimensionit lind kriza në përgjithësi, e ajo ekologjike dhe ndërnjerëzore në veçanti. Ne nuk jemi të pavarur nga ambienti. Ne jetojmë, jo vetëm, në botën njerëzore, ashtu siç jemi mësuar të mendojmë, por jetojmë në ambient në mes të natyrës; ne nuk jetojmë në mes të 'natyrës së vdekur',<sup>15</sup> por në mes të natyrës së gjallë, në mes të jetës. Ajo na detyron të mendojmë ndryshe, të mendojmë më thellë për marrëdhëniet tona edhe me jo njerëzit.

Kriza ekologjike dhe mungesa e raporteve ndërnjerëzore që, para së gjithash, është një pasefekt i përlyerjes së shpirtit<sup>16</sup>, e tregon edhe gjendjen e përgjithshme të njerëzimit dhe planetit, për sa i përket kërcënimit ekstrem për mjedisin natyror të njeriut, duke e përfshirë ajrin, tokën, ujërat dhe speciet bimore dhe shtazore. Kriza mjedisore, gjegjësisht ndotja e ajrit, ndotja e ujit, ngrohja globale, por edhe zhdukja e vlerave morale njerëzore<sup>17</sup>, janë një kërcënim për jetën dhe kushtet e jetesës në një shkallë të gjerë, ose më qartë një kërcënim për natyrën. Nga ndotja mekanike dhe varfërimi i 'burimeve' natyrore, përmes manipulimeve më delikate, të rrezikshme biogjenike, e deri në kërcënimin e pafund të kataklizmave bërthamore, dukuritë e kësaj krize janë të panumërta dhe nuk mund të mohohen më as nga optimistët më të mëdhenj.<sup>18</sup>

Shkatërrimi i natyrës me anë të një mega-aparati teknik, kryhet mbi supozimet e shkencës moderne natyrore, të cilës i mungon shpirtënia dhe e cila ka nevojë për një shkencë tjetër<sup>19</sup>, dhe shkenca e tillë nuk është vetëm antinatyrore, por edhe antinjerëzore, sepse nuk është vetëm natyra jonjerëzore ajo që merr pjesë në lëndën e manipulimit tekno-shkencor dhe, madje, edhe të privatizimit ekonomik në krijimin dhe ruajtjen e kushteve të jetës njerëzore, por edhe ajo që e rrënon edhe vetë natyrën e njeriut, për shembull, strukturën e tij gjenetike. Organizimi i shoqërisë i bazuar në teknologji ka rezultuar me krizën

<sup>14</sup> Shih, Kalin, Ibrahim, *Horizonte të hapura-mbi mendimin e mirë, të drejtë dhe të bukur*, LogosA, Shkup, 2022, f. 39.

<sup>15</sup> Shih, Izeti, Metin, *Virtyti i jetës si njeri dhe bioetika*, LogosA, Shkup, 2020, f. 14-15.

<sup>16</sup> Nasr, Sejjid Husein, *Islam in Modern World, Challenged by the West, Threatened by Fundamentalism, Keeping Faith with Tradition*, Neë York, 2010, f. 1-41.

<sup>17</sup> Shih, Kaya, Osman, "Kur'an'a ve Sunnete Gore Çevre Bilinci ve Ahlakı", *DUIFAD*, Duzce, 2016, f. 81-95; Macit, Yunus, *Islami Perspektifte Çevrecilik*, Eser Ofset, Trapzon, 1999, f. 16-17.

<sup>18</sup> Izeti, *Virtyti i jetës si njeri dhe bioetika*, f. 14-15.

<sup>19</sup> Shih, Dubois, Michel, *Hyrje në sociologjinë e shkencave*, LogosA, Shkup, 2019, f. 34-35.

ekologjike, gjegjësisht me ndotjen e ambientit jetësor, madje, edhe deri të dehumanizimi i njeriut.<sup>20</sup>

Në anën tjetër, njerëzishtja është një “gjuhë” jo vetëm virtuale, por dhe trupore, e cila e përbën identitetin e vërtetë të njeriut. Ajo i jep kuptim identitetit, gjegjësisht vetë njeriut. Kjo “gjuhë” sikur që është gjuha e bujarisë, mëshirës, sinqeritetit, seriozitetit, burrërisë, bamirësisë, patriotizmit etj., ajo është edhe gjuha e zilisë, inatit, refuzimit, prishjes, shkatërrimit, çoroditjes, injorancës, hasedit, smirës, urrejtjes, mashtrimit, spiunimit, shpifjes etj. Gjuhën e njerëzishtes, pa dyshim që e ka të qartë Krijuesi Fuqiplotë dhe vetë njeriu, si pronar i saj. Po e vërteta e saj është se, ajo për të gjithë ne, në fillim nuk dëgjohet e as nuk duket. Ajo shpaloset në rrethana të caktuara, madje në rrethana kur edhe pronari i saj nuk dëshiron që ajo të del në pah. Gjegjësisht ajo kuptohet kur merr formë në sjelljen, qëndrimin dhe veprimin apo mimikat e njeriut. I treti, ose tjetri, këtë gjuhë nuk mund ta kuptojë pa e treguar pronari, ose pa i dhënë mundësi Zoti, që ajo në një kohë të del në shesh.

Mendoj se, nëse njeriu nuk është duke vepruar ose folur me gjuhën e njerëzishtes, gjegjësisht me gjuhën origjinale të tij, pra nëse njeriu nuk e vepron atë që e mendon, e ndjen dhe e dëshiron, atij nuk i vlen as puna, as dija, as shërbimi e as jeta, pa marrë parasysh zanati, profesioni, vendi ku jeton dhe koha se kur jeton. Problemi nuk është te zanati, profesioni, aftësia, njohja e shumë gjuhëve, kultura e gjerë etj., por tek mungesa e origjinale së njeriut, gjegjësisht mungesa e gjuhës së njerëzishtes, konkretisht gjuha e trupit, e cila përputhet me gjuhën e zemrës, shpirtit dhe atë virtuale.<sup>21</sup> Sot libra ka plotë, vepra arti ka plotë, shkolla e universitete ka plotë, mundësi për të fituar njohuri/dituri ka plotë, por problemet janë me shumicë, madje shtohen edhe më. Pse ndodh kjo? Arsyeja thelbësore për këtë është ajo se, në këtë kohë njeriu gënjeshtar, mashtrues, interesxhi, dallaverexhi, mercenar, prezantohet si fetar, administrator, udhëheqës, mësues, profesor, politikan etj. Ndërkaq, suksesin nuk e bën profesioni. Profesioni është një mjet i mirë për sukses. Por realisht njerëzishtja është ajo që e bën të mundshëm suksesin. Paramendoni një njeri gënjeshtar, shpifës, vjedhës etj., që del dhe flet ose proteston për pastërtinë ekologjike. Pastërtia ekologjike nuk është fjalë boshe. Ajo duhet të burojë nga shpirti. Pa pastërti shpirtërore nuk ka mundësi të ketë as pastërti ekologjike e as raporte të mira ndërnjerëzore.

<sup>20</sup>Shih, Ozel, Ismet, *Tri çështjet: teknika-civilizimi-tëhuajësimi*, LogosA, Shkup, 2009, f. 167.

<sup>21</sup>*es-Saff*: 2-3.

Zoti nuk përmend asnjëherë se shkatërrimi njerëzor mund të shtrihet në qiej, sepse kjo është zona e engjëjve, që vetëm mund t'i nënshtrohet Zotit. Kjo ndihmon që të shpjegojmë pse protestuan engjëjt në krijimin e Ademit duke thënë, “Si, Ti do vendosësh atje dikë që prodhon shkatërrim dhe derdh gjak?”<sup>22</sup> Si engjëj, ata ishin të paaftë për të shkakuar çoroditje/shkatërrim. Çoroditja/shkatërrimi është mundësi vetëm midis atyre që bëhen nga balta. Nëse engjëjt do të kishin trupa prej balte, edhe mund të bënin konfuzion-siç e provuan për të keqen e tyre Haruti dhe Maruti. Në rendin universal, çoroditja apo shkatërrimi është cilësi ekskluzivisht njerëzore. Vetëm mëkëmbësia u jep krijesave liri për të punuar kundër Krijuesit. Vetëm amaneti i keqpërdorur mund të shpjegojë se si mund të shfaqet e keqja morale në univers. Edhe Iblisi nuk shkaktoi çoroditje përpara se të krijohej Ademi. Liria e xhindëve për të mos iu bindur Zotit lidhet në një farë mënyre me mëkëmbësinë njerëzore. Vargu në vazhdim duket i përshtatshëm veçanërisht për botën moderne.<sup>23</sup> Vështirë se mund të jetë kuptuar plotësisht domethënia e tij përpara se teknologjia moderne e ndotja industriale ta bënin vetëshkatërrimin e racës një opsion real: “Çoroditja/shkatërrimi është shfaqur në tokë e në det për shkak të asaj që kanë fituar duart e njeriut...”<sup>24</sup>

## Conclusion

In short, faith or the spiritual dimension, namely the sacred, or awareness of the vicariousness and of God, with environmental pollution, namely the ecological crisis and the breakdown of interpersonal relationships, are always, mutually, a challenge to each other. Where spirituality, the sacred, is strong, the ecological crisis has no place. Meanwhile, where the ecological crisis is dominant, it indicates the lack or misuse, weakness, and absence of spirituality, of the sacred. It is the spiritual or sacred that which is permanent and complete and which precisely because of its completeness supports the psychic and even physical aspects of man and transforms and illuminates them. The world today needs more than ever, an elevation and advancement of spirituality, for non-abuse of the sacred, so that we do not have environmental pollution and pollution of interpersonal relationships. This,

<sup>22</sup> *el-Bekare*: 30.

<sup>23</sup> Shih, Chittick, William dhe Sachiko Murata, *Vizioni i Islamit*, albPAPER, London and Neë York, 2000, f. 398-399.

<sup>24</sup> *er-Rum*: 41.

in my opinion, is achieved through human awareness of the responsibility they have towards other people and the environment in general. Human awareness is achieved only by knowing oneself, and this is achieved through the knowledge of tradition, culture, and civilization, which are not simply technical and material, but at the core of which lie universal values such as ethics, aesthetics, morality, truth, and sincerity.

### **Recensentë:**

**Prof. dr. Ibish Kadriu**

**Prof. dr. Abdilnaser Sinani**

### **Literatura:**

Chittick, W. & Murata, S. (2000). *Vizioni i Islamit*. London and New York: albPAPER.

Dubois. M. (2019). *Hyrje në sociologjinë e shkencave*. Shkup: LogosA.

Hafizoviq, R. (2022). *Njohja-vlera e parë e Islamit*. Tiranë: Alsar.

Ibrahim, K. (2022). *Horizonte të hapura-mbi mendimin e mirë, të drejtë dhe të bukur*. Shkup: LogosA.

Izeti, M. (2020). *Virtyti i jetës si njeri dhe bioetika*. Shkup: LogosA.

Kaya, Ö. (2016). "Kur'an'a ve Sunnet'e Göre Çevre Bilinci ve Ahlaki". *DÜİFAD*, V: XVIII, No: 2, Diyarbakir: Dicle Üniversitesi İlahiyat Fakültesi, pp. 81-95.

Kur'an. *el-Ahzab*: 72.

Kur'an. *el-Bekare*: 30.

Kur'an. *el-Me'arixh*: 19.

Kur'an. *er-Rum*: 41.

Kur'an. *es-Saff*: 2-3. Kur'an. *et-Tin*: 4.

Macit, Y. (1999). *Islami Perspektifte Çevrecilik*. Trapzon: Eser Ofset.

Muhamed, M. (2004). *Një marrëveshje e re për Azinë*, Shkup: BFI-FSHI.

Nasr, S. H. (2010). *Islam in Modern World, Challenged by the West, Threatened by Fundamentalism*, New York: Keeping Faith with Tradition.

Özel, I. (2009). *Tri çështjet: teknika-civilizimi-tëhuajësimi*. Shkup: LogosA.

Sardar, Z. (2017). *Fryma e Islamit*, Shkup: LogosA.